



PLANI I ZHVILLIMIT I KOMUNES GOLAJ



**PLANI I ZHVILLIMIT I KOMUNES
GOLAJ
(Qarku i Kuksit)**

PER VITET 2011-2015

Nentor, 2012

PERMBAJTJA E LENDES

Permbajtja e lendes	2
Parathënie.....	4
Plani i Zhvillimit Komuna Golaj	6
Hyrje – Vlerësim i përgjithshëm.....	6
Hapat e ndjekur në hartimin e Planit te Zhvillimit (PV).....	9
Përmbledhje e profilit të Komunes Golaj	10
Historiku i Komunës Golaj	10
Pozicioni gjeografik dhe karakteristikat natyrore	10
Popullsia.....	12
Ndihma ekonomike	14
Strehimi dhe urbanizimi.....	15
Furnizimi me Ujë të pijshëm.....	15
Rrjeti i kanalizimeve	15
Burimet dhe përdorimi i energjisë	15
Sistemi arsimor	16
Shëndeti publik	18
Mjedisi dhe gjelbërimi	18
Infrastruktura rrugore.....	19
Bizneset dhe punësimi	21
Të ardhurat e Komunës Golaj	21
Shpërndarja e buxhetit për vitin 2012.....	22
Vizioni per vitin 2015	23
Objektivat e pergjithshem te zhvillimit te Komunes Golaj	23
Matrica e projekteve Viti 2012	24
Matrica e projekteve Viti 2013	25

Matrica e projekteve Viti 2014	26
Matrica e projekteve Viti 2015	27
Anex 1 Grupi konsultativ Golaj.....	28
Vendimi i keshillit te Komunes Golaj.....	29

PARATHËNIE

Plani i Veprimit dhe Zhvillimit të Komunës Golaj është realizuar në kuader të projektit “Fuqizimi i Rolit të Komunitetit në Planifikimin Strategjik për Zhvillimin Lokal” i financuar nga Balkan Trust for Democracy dhe implementuar nga RASP (Programi i Mbeshtetjes së Shoqatave Rurale), dhe është realizuar në bashkëpunim me Qendrën e Keshillimit të Grave dhe Shërbimeve Sociale dhe Komunën Golaj.

Balkan Trust for Democracy (BTD) është një iniciativë me një histori veprimtare 10 vjeçare, që mbështet demokracinë, qeverisjen e mirë dhe integrimin Euroatlantik në Europën Juglindore. Ky partneritet publiko-privat, që ka fituar mjaft çmime është krijuar fillimisht në vitin 2003 nga German Marshall Fund i SH.B.A, Agjensia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Kombëtar (USAID) dhe Fondacioni Stewart Mott.

RASP (Programi i Mbeshtetjes të Shoqatave Rurale) është një organizatë me qendër në Tiranë, misioni i së cilës mbështetet në stimulimin e mundësive për banorët e zonave rurale për të përmirësuar jetesën dhe reduktuar varferinë, nëpërmjet shfrytëzimit të mirë të burimeve natyrore, kulturore dhe njerezore për të arritur një zhvillim të qendrueshëm. RASP ka një eksperiencë të gjatë në zhvillimin e projekteve me pjesëmarrje të gjerë të komunitetit dhe në fokus të këtyre projekteve është zhvillimi i zonave rurale, forcimi i demokracisë dhe rolit të shoqërisë civile në planifikim, hartim dhe implementim të dokumentave strategjike, planeve të zhvillimit, veprimit të zonave ku ata jetojnë .

Qendra e Keshillimit të Grave dhe Shërbimeve Sociale ka si mision të saj ofrimin e programeve dhe shërbimeve për gratë dhe vajzat në nevojë në rajonin e Kukësit ku ushtron aktivitetin e saj por jo vetëm. Përfshirja e QKGSHS-së ka qënë thelbësorë në punë me komunitetin e Komunës Golaj për të rritur ndërgjegjësimin dhe aktivizimin e përfaqësuesve të këtyre komuniteteve në planifikimin strategjik për zhvillimin lokal.

Synimi i këtij dokumenti është të ofrojë Pushtetit vendor, Qeverisë shqiptare, donatorëve bilateral dhe multilateral, organizatave Qeveritare dhe jo Qeveritare një program zhvillimi për promovimin e mbështetjes dhe investimeve të shërbejë si një mekanizëm planifikues, i cili kombinon prioritetet sipas sektoreve dhe fshatrave, prioritetet të cilat janë artikuluar nga drejtues të organeve vendore.

Komuna Golaj ka nje potencial te madh zhvillimi, me bukuri te vecante natyrore dhe ne kete kuader Plan i Zhvillimit dhe Veprimit i Komunës Golaj synon të përmbledhë të gjitha prioritet e zones në një “dokument” të vetëm që do shërbejë si një guidë në zhvillimin e komunes ne te ardhmen. Me mbështetjen e pushtetit lokal është realizuar një proces pozitiv për hartimin e këtij plani me nje pjesemarrje te gjere te komunitetit duke zbatuar Kodin e praktikës se mire ne te gjitha hallkat e tij si Percaktimi i axhendes, Draftimi, dhe miratimi, dhe ky process do te vazhdoje edhe me fazat e Implementimit, Monitorimit dhe Riformulimit.

PLANI I ZHVILLIMIT KOMUNA GOLAJ

Hyrje – Vlerësim i përgjithshëm

Plani i Zhvillimit të Komunës Golaj përfshin mbështetjen për planifikimin dhe përmirësimin e shërbimeve publike, reformat administrative dhe ato të menaxhimit, si dhe rritjen e komunikimit dhe pjesëmarrjes së qytetarëve drejt një qeverisjeje lokale me të përgjegjshme dhe transparente.

Qëllimi i këtij dokumenti është të shërbejë si një dokument udhërrëfyes, i cili identifikon prioritetet kyç të zhvillimit të ardhshëm të Komunës, duke orientuar çështje si ato të zhvillimit ekonomik, ndërhyrjet për përmirësimin e infrastrukturave fizike dhe sociale, shpërndarjen dhe kapacitetet e nevojshme të shërbimeve publike, planifikimin dhe menaxhimin e territorit, etj.

Plani i Zhvillimit të Komunës Golaj është produkt i një procesi të hapur pjesëmarrjeje disamujore, i udhëhequr nga grupi i punës, i përfshirë në një cikël takimesh debatuese dhe konsultative. Ekipi i përbashkët i punës ka përfshirë përfaqësues të administratës vendore të Komunes, Këshillit të Komunës, grupe të ndryshme interesi lokale (intelektuale, biznesmenë, gra, të rinj nga Shkolla e Mesme, pensionistë etj), si dhe partnerë të tjerë që janë duke ushtruar veprimtarinë e tyre në territorin e Komunës. Nxitja e pjesëmarrjes së komunitetit, bazuar në forma jodiskriminuese dhe paanshmëri në lidhje me moshën, gjininë, racën, etninë, përkatësinë fetare apo bindjet politike, i ka shërbyer qëllimit për të siguruar legjitimitet dhe konsensus ndërmjet palëve lidhur me planin, aktivizimin e komunitetit në vendimarrje, rritjen e nivelit të transparencës së autoriteteve vendore gjatë ushtrimit të detyrave administrative dhe shkallës së ndërgjegjësimit mbi gamën e problemeve dhe pritshmërive që ka komuniteti vendas, të gjitha këto si elemente të rëndësishme për një qeverisje të mirë.

Duke përcaktuar axhendën e zhvillimit të zonës, Plani i Zhvillimit të Komunës Golaj i shërben rritjes së mirëqëniesse të gjithë komunitetit. Plani identifikon një proces të tërë, në të cilin angazhohen jo vetëm strukturat e administratës lokale të Komunes, por edhe aktorët kryesorë, grupet e interesit dhe banorët e kësaj Komune.

Në saj të përfshirjes së komunitetit në procesin e përgatitjes së tij, Plani i Zhvillimit orientohet sipas koncepteve vizionare të komunitetit në lidhje me zhvillimin. Duke qënë se në mentalitetin tone të zhvillimit dhe të planifikimit kanë munguar modelet vizionare, që shpjegojnë se ku dhe si

do të orientohen potencialet ekzistuese, plani i propozuar i bashkëngjitet me një ekuilibër më të arrirë zhvillimit rajonal të Kukësit, duke u koordinuar sipas të gjitha fushave përkatëse.

Plani i Zhvillimit është konceptuar si një lloj kontrate aksionesh midis autoriteteve vendore dhe qytetarëve, e cila specifikon llojin, sasinë dhe formën e zhvillimit, duke mbrojtur me çdo kusht mjedisin dhe vlerat. Për këtë arsye plani është i fokusuar të ndërtojë një program pune me një plan veprimesh konkrete, që synon të fillojë dhe të influencojë proceset e ardhshme të zhvillimit. Plani adreson premtimet e bëra nga Kryetari i Komunës Golaj gjatë fushatës zgjedhore, nevojat bazë, kërkesat dhe sfidat e banorëve, nëpërmjet shfrytëzimit racional të potencialeve dhe burimeve ekzistuese.

Duke u bazuar në ligjin ekzistues të Qeverisjes Vendore në Shqipëri, Plani i Zhvillimit të Komunës Golaj e ka konsoliduar vlerën e tij ligjore dhe detyruese për zbatim, që në momentin e miratimit nga Këshilli Komunal.

Promovimi i zhvillimit ekonomik lokal, furnizimi me shërbimet bazë publike, mbrojtja e mjedisit, përmirësimi i kontrollit mbi territorin dhe proceset e planifikimit urban janë ndër detyrat kryesore për çdo njësi vendore. Të gjitha këto kanë nevojë për planifikim, për të siguruar kështu një zhvillim koherent dhe të qëndrueshëm.

Në këtë mënyrë, Plani i Zhvillimit plotëson këto kritere:

- a) ai është një dokument që orienton veprimet e Bashkisë duke e mundësuar këtë të fundit, që të veprojë sipas një vijimësie të qartë procesesh dhe aktiviteteve në vite,
- b) plani i mundëson komunitetit lokal që të përpunojë një vizion të përgjithshëm, për të ardhmen e njësisë vendore, duke përcaktuar në të njëjtën kohë edhe misionin e autoriteteve vendore,
- c) plani është një instrument që propozon një seri projektesh dhe veprimesh, të cilat Bashkia mund t'i adresojë në Qeverinë Qendrore apo në partnerë të tjerë financiarë si psh: në agjencitë donatorë, për të siguruar kështu financime të vazhdueshme,
- d) ai është një instrument që vjen si rezultat i një procesi pjesëmarrës, gjatë të cilit banorët kanë mundur që të përcaktojnë nevojat e tyre, si dhe prioritetet për veprim,

- e) plani trajton të gjitha çështjet prioritare që shqetësojnë jetën e përditshme të banorëve,
- f) plani është i njohur nga banorët, dhe i lejon autoriteteve të Bashkisë që të veprojë në mënyrë transparente në mbështetje të tyre,
- g) plani është një dokument që lejon veprime efektive, duke përfshirë në vetvete një proces monitorues, i cili mundëson rishikimin periodik të objektivave dhe veprimeve, vetë banorët janë të përfshirë në procesin e rishikimit.

Plani është fleksibël dhe krijon hapësira për ndryshime të mundshme të bazuara në kriteret e nevojave që mund të dalin si pasojë e situatave të ndryshme të paparishikuara, zhvillimeve të reja dhe përmirësimeve të vazhdueshme, që do të dalin si rezultat i punës së Pushtetit Vendor përgjatë zbatimit. Pa dyshim këto ndryshime do të realizohen duke iu referuar kërkesave dhe nevojave specifike, sipas grupeve përkatëse të interesit.

Plani i Zhvillimit është hartuar duke u bazuar në mundësitë reale të Komunës Golaj, si në kuptimin e këndvështrimit të burimeve njerëzore ashtu dhe të atyre financiare, ndërkohë pa munguar dhe shmangur ato ndërhyrje të rëndësishme strategjike, të cilat mund të shkojnë përtej kapaciteteve apo burimeve ekzistuese të Komunës.

Ai është transparent në kuptimin se ky dokument në vetë llojin e tij është i hapur ndaj propozimeve të përfshira, që janë diskutuar nga vetë komuniteti, biznesi apo grupe të tjera, të cilat kanë një ndikim të rëndësishëm. Në këtë mënyrë Plani i Zhvillimit nxit rritjen e besimit përkundrejt Pushtetit Vendor, dhe përgjegjshmërinë gjatë kohës së zbatimit të tij.

Pa dyshim që administrata e Komunës mbetet aktori kryesor përgjegjës për zbatimin e këtij dokumenti, në linjë me procesin periodik të planifikimit dhe të buxhetimit. Të tjerë aktorë të përfshirë në proces do të japin ndihmesën e tyre në monitorimin dhe përditësimin e vazhdueshëm të planit.

Nga ana tjetër, për shkak të tranzicionit në vazhdim, në Shqipëri priten ndryshime të shumta, që do të reflektohen padyshim në rajonin e Kuksit dhe në Komunën Golaj. Për këtë arsye rishikimi i Planit të Zhvillimit duhet të jetë një subjekt reflektimi i vazhdueshëm. Plani duhet të rishikohet në mënyrë periodike, duke adoptuar dhe integruar ndryshimet

e shkaktuara nga zhvillimet apo tendencat e reja të tranzicionit në Shqipëri.

Hapat e ndjekur në hartimin e Planit të Zhvillimit (PV)

Nr	Aktivitetet	Kush	Koha	Vendi
	Ngritja e grupit të punës për hartimin e Planit të Veprimit	Stafi RASP	Shkurt 2012	Golaj
	Trajnimi i antarëve të grupit për “Pjesmarrja e komunitetit në vendim marrje”	Stafi RASP	Mars 2012	Golaj
	Mbledhja e të dhënave	Grupi i punës	Mars-Prill	Golaj
	Analiza e situatës	Grupi i punës	Prill	Golaj
	Takime me grupet e interesit - Grupi i përfaqësuesve të 5 fshatrave - Grupi përfaqësuesve të fshatrave të mbetur Grupi i intelektualëve + Grupi i	Grupi i punës	Prill - Maj	Golaj
	Krijimi i grupit konsultativ	Grupi i punës, Drejtuesit e	Korrik 2012	Golaj
	Përpunimi i draftit		Korrik - Gusht	Golaj
	Marrja e vërejtjeve, sugjerimeve të komunitetit dhe konsultime me Këshillin Komunal		Gusht – Shtator	Golaj
	Miratimi në Këshillin Komunal		Tetor 2012	Golaj

PËRMBLEDHJE E PROFILIT TË KOMUNES GOLAJ

Historiku i Komunës Golaj

Komuna Golaj përbëhet nga 12 fshatra: Golaj, Nikoliq, Bardhaj, Perollaj, Vlahen, Letaj, Peraj, Dobrunë, Zgjec, Qarr, Helshan dhe Kosturr; ka një popullsi prej 8065 banorë. Pjesa më e madhe e popullsisë është e përqëndruar në tre fshatra: Golaj, Vlahen dhe Nikoliq.

Pozicioni gjeografik dhe karakteristikat natyrore

Komuna Golaj shtrihet në rrethin e Hasit, ka një popullsi me 8195 banorë, me 2200 familje dhe një shtrirje gjeografike të tillë që: në Veri kufizohet me Komunën Bytyq, në Lindje me shtetin e Kosovës, në Jug me Bashkinë Krume, në Perëndim me Malzi, Kukës.

Komuna Golaj ka një sipërfaqe prej 162 km², të ndarë si më poshtë:

Territori I Komunës Golaj:

Sipërfaqja pyjore gjithsej 10081.1 ha Nga kjo:

 Trungishte 798.2 ha

 Cungishte 8662.9 ha

 Shkurre 620.0 ha

Sipërfaqe kullota 3210.1 ha

Sipërfaqe jopyjore 2866.8 ha

Nga kjo:

 sipërfaqe bujqësore dhe urbane 2699.6 ha

 sipërfaqe ujore 40.7 ha

 sipërfaqe shkëmbore 126.5 ha

Totali I sipërfaqes së Komunës Golaj = 16158.0 ha.

Bujqësia dhe blegtoria janë fushat kryesore të zhvillimit, por kohët e fundit edhe industria e nxjerrjes së mineraleve ka filluar të zhvillohet.

Komuna ka 12 fshatra

Komuna Golaj ka Këshillin e Komunës me 15 anëtarë, të ndarë sipas numrit të votave të marra nga subjektet politike që morën pjesë në zgjedhjet lokale të Majit 2011.

Raporti në Këshill është si më poshtë.

Këshilli aktualisht është ndarë në këto Komisione:

- Komisioni i Verifikimit të mandateve.
- Komisioni Juridik dhe i pronave të Komunës.
- Komisioni i Financës dhe Zhvillimit Ekonomik.
- Komisioni i Planifikimit Urban dhe Infrastrukturës.
- Komisioni i Arsimit, kulturës dhe sportit.
- Komisioni i Shëndetit dhe ruajtjes së mjedisit.

Për raste të veçanta Këshilli ngre komisionet përkatëse. Këshilli i Komunës dhe administrata e zhvillojnë punën e tyre duke u bazuar në Ligjin nr.8652, dt.31.07.2000 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Pushtetit Lokal” i ndryshuar.

Me vendim të Këshillit të Komunës Nr 03, datë 06/02/2012 është miratuar Struktura organike e aparatit dhe niveli i pagave për çdo vend pune.



Tabela 1 **Struktura e aparatit të Komunës Golaj Viti 2012**

Nr.personelit sipasstrukturës	Administratë	Punonjës	Nr.Faktik në total	Me arsimtelartë	Me arsim të mesëm	Meshkuj	Femra	Femra në poste drejtuese
42	17	25	42	9	8	31	8	1

Popullsia

Komuna Golaj ka një popullsi me 8195 banorë, me 2200 familje

Aktualisht janë 3.7 banorë/familje.

Tabela 2 **Te dhëna për popullsinë**

Fshati	Popullsia	Meshkuj	Femra	Nr. familjeve
Golaj	1785	904	881	411
Nikoliq	1161	581	580	329
Vlahen	1279	635	644	338
Letaj	685	345	340	183
Perollaj	455	221	234	125
Qarr	474	242	232	156
Helshan	995	481	514	147
Kosturr	495	243	252	163
Peraj	271	138	133	93
Dobrune	255	129	126	87
Zgjeç	268	135	133	93
Bardhaj	130	67	63	42
TOTALI	8253	4121	4132	2148



Pamje nga fshati Vlahen

Ndihma ekonomike

Tabela 3 Familje me ndihmë ekonomike

Nr	Fshati	Numri i familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike
1	Golaj	184
2	Vlahen	158
3	Nikoliq	109
4	Helshan	83
5	Letaj	75
6	Kosturr	41
7	Qarr	52
8	Perollaj	47
9	Dobrunë	27
10	Zgjeç	33
11	Peraj	16
12	Bardhaj	14
	Totali	839

Strehimi dhe urbanizimi

Në bazë të planit të organizimit të ri urbanistik mbi planifikimin e planit urban nuk është bërë asnjë projekt –plan për fshatrat e komunës Golaj. Kjo është për disa arsye, si me poshtë:

Problemet e pronësisë që janë evidente në çdo fshat
Rregjistrimi i pronave pranë hipotekës nuk është bërë

Komuna nuk ka një plan strehimi, ndërkohë të pastrehët gjejnë mundësi strehimi tek të afërmit e tyre.

Furnizimi me Ujë të pijshëm

Duke parë zhvillimin e viteve të fundit, vihet re se dhe nevojat për ujë të pijshëm janë në rritje. Furnizimi me ujë të pijshëm në fshatra ekziston me çezma publike dhe mbulon 30% të banorëve. Në fshatin Nikoliq ujësjellësi funksionon dhe mbulon 50% të popullatës. Në fshatrat e tjera nuk funksionojnë rrjetet e ujësjellësit si në Golaj, Bardhaj, Dobrone, ku janë bërë investime, janë jashtë funksionit.

Kriteri themelor i planifikimit të sasisë ditore të ujit në qytet duhet të jetë që komuniteti të ketë ujë pa ndërprerje gjatë gjithë ditës në rrjetin e shpërndarjes dhe me presion të stabilizuar.

Rrjeti i kanalizimeve

Duhet theksuar se për rrjetin e kanalizimeve të ujrave të zeza nuk ka një sistem të përcaktuar. Këto ujëra janë të patrajuara, ç'ka përbën një faktor të lartë ndotjeje dhe shtim të sëmundjeve në popullatë

Kanalet e ujrave të zeza janë shumë të domosdoshme, sidomos në fshatin Letaj, Golaj nuk është kryer asnjë investim për rehabilitimin e tyre për mungesë fondesh.

Burimet dhe përdorimi i energjisë

Fshatrat në përbërje të Komunës Golaj, furnizimin me energji e marrin tërësisht nga rrjeti kombëtar. Burime alternative janë drutë e zjarrit. Energjia elektrike përdoret përgjithsisht për ndriçim, gatim e ngrohje, por si rezultat i rritjes së çmimit të energjisë elektrike dhe druve të zjarrit, vitet e fundit vihet re një përdorim më i gjerë i gazit si për gatim edhe ngrohje.

Në vitin 2010 nga një firmë Italiane janë bërë disa studime për energji me erë dhe sondazhi është kryer në Qafën e Prushit me vendosjen e antenës matëse.

Sistemi arsimor

Kjo Komune ka 1 shkollë të Mesme në fshatin Golaj me 181 nxenes dhe 8 shkolla 9-vjecare përkatësisht në fshatrat Golaj, Nikoliq, Vlahen, Letaj, Zgjec, Perollaj, Helshan dhe Kosturr me 1296 nxënës dhe 1 shkollë e ciklit të ulët në fshatin Dobrunë.

Tabela 4. Të dhëna për edukimin

Emërtimi	Kopshte			Shkolla 9 vjeçare			Shkalla të Mesëm		
	Nr	Fëmijë	Edukator	Nr	Nxënës	Mësues	Nr	Nxënës	Mësues
Komuna Golaj	9	194	9	8	1296	89	1	181	6



Pamje të shkollës 9-vjecare Letaj,e cila ka nevojë për rikonstrukcion ose ndërtimin e një shkolle të re.



SHKOLLA E MESME E BASHKUAR GOLAJ



SHKOLLA 9-VJECARE NIKOLIQ

Të rikonstruuaruara dhe me kushte të përshtatshme për mësim.

Shëndeti publik

Tabela 5. Të dhëna për personelin mjekësor

Nr. mjekëve	Infermierë-mami
Gjithsej Komuna	17
Golaj	2
Nikoliq	2
Vlahen	2
Letaj	1
Qarr	1
Dobrune	1
Peraj	1
Zgjec	1
Perollaj	1
Helshan	2
Kosturr	2
Bardhaj	1

Mjedisi dhe gjelbërimi

Komuniteti gëzon një frymë bashkëpunuese që vihet re në kërkesat për përmirësimin e kushteve mjedisore të Komunës dhe në nismat e ndryshme të institucioneve.

Shtimi dhe përmirësimi i mjediseve të gjelbra është një tjetër element, i cili duhet të merret në konsideratë për krijimin e një mjedisi të shëndetshëm dhe estetik. Kjo në radhë të parë kërkon përcaktimin konkret në terren të zonave të gjelbra, dhe specifikimin e instrumenteve për mbrojtjen dhe zhvillimin e tyre në të ardhmen.

Tabela 6. Sipërfaqjet në m² dhe numri I pemëve

Emërtimi	Nr i pemëve ekzistuese	
	Nr. faktik copë	Planifikuar të mbillen në vitin 2012 copë
Golaj*	7	5
Nikoliq*	5	5
Letaj*	3	3
Zgjec*	2	3
Kosturr*	2	3
Dobrune*	2	3
Vlahen*	4	2
Perollaj*	3	4
Qarr*	3	3
Peraj*	2	4
Komuna Golaj	33	35

Infrastruktura rrugore

Komuna Golaj ka një rrjet rrugor problematik (mungesë totale e trotuareve)

Megjithë përpjekjet e bëra për mirëmbajtjen ose rikonstruksionin e disa prej tyre, gjëndja paraqitet jo e mirë. Kërkohet ndërhyrje urgjente për përmirësimin e gjëndjes.



Pamje nga rruga e fshatit Vlahen

Tabela 7. Të dhëna për infrastrukturën rrugore

Emërtimi	Gjatësia e rrugëve m ² sipas gjëndjes së tyre			
	Gjithsej m ²	Gjendje te keqe m ²	Gjendje mesatare m ²	Gjendje te mire m ²
Golaj	10	7	2	1
Nikoliq	12	10	1.5	0.5
Helshan	5	3	1	1
Qarr	4	4	0	0
Peraj	3	2	1	0
Zgjeç	4	3	1	0
Perollaj	5	3	1	1
Letaj	5	4	1	0
Vlahen	15	8	7	0
Bardhaj	3	2	1	0
Dobrune	8	7	1	0
Kosturr	8	6	2	0
Totali	82	59	19.5	3.5

Bizneset dhe punësimi

Biznesi nuk është i zhvilluar në këtë Komunë. Ekonomitë familjare janë shumë të dobëta. Edhe pse ka resurse të mineraleve, ato burime shfrytëzohen nga firma të huaja që në fund nuk lënë asgjë për komunitetin e kësaj komune.

Table 8 Te dhena per biznesin

Emertimi	Biznese prodhuese		Sherbime	
	Nr	Te punesuar	Nr	Te punesuar
Komuna Golaj	3	43	40	50

Të ardhurat e Komunës Golaj

Table 7. Grandet dhe buxheti sipas viteve 2007 – 2012 (ne mije leke)

Emërtimi	Viti 2010		Viti 2011		Viti 2012	
	Grand	Buxheti	Grand	Buxheti	Grand	Buxheti
	28,019	28,919	27,179	28,790	27,358. 6	30,520

Shpërndarja e buxhetit për vitin 2012

Tabela 8 **Buxheti për vitin 2012 – Komuna Golaj**

Emertimi	Buxheti gjithsej 000/ lek	Shperndarja sipas zerave kryesor													
		Investime		Kopsht e + Çerdhe		Sherbime publike		Qendra kulturor e		Konvikti		Administ rata		Te tjera Mbjellje drufrutore	
		Leke	%	Leke	%	Lek e	%	Lek e	%	Leke	%	Leke	%	Leke	%
	30520	2800	9	0	0	918	3	0	0	0	0	1578	5	2750	9
						1	0					9	2		

VIZIONI PER VITIN 2015

Per nje Komune te urbanizuar, me mireqenie dhe jete te permirsuar

Per nje Komune ku njerzit te ndjehen te respektuar dhe te vlersuar ne jeten ne komunitet dhe ne qeverisjen vendore

Per nje Komune me ekonomi te zhvilluar, me profil te promovuar, me biznes dhe treg bashkekohor

Objektivat e pergjithshem te zhvillimit te Komunes Golaj

1-Te rriten mundesite per zhvillimin e turizmit ne Komunen Golaj

2-Te permiresohet infrastruktura rrugore, ajo shkollore dhe sistemi vadites .

3-Te rritet sasia dhe cilesia e sherbimeve ndaj komuniteti

MATRICA E PROJEKTEVE VITI 2012

Nr	Emertimi i aktivitetit Veprimi	Veprimi	Pritshmëria	Afati - viti	Fondi i nevojshëm m 000/leke	Kush mund ta financojë	Indikatorët – Treguesit e matshëm
1	Ngritja e një strukture për hartim projektesh	1-Evidentimi i personave potencial 2-Trajnimi i tyre nga Sekretariati Teknik ne Kukës per fondet IPA 3-Angazhimi i tyre	Staf i përgatitur për projekte të hartuara nga stafi i Bashkisë	6 muaj	30000	Komuna Sekretariati Teknik në Kukës Qarku Kukës	Numri i personave të evidentuar, numri i personave të trajnuar.
2	Përmirësim urbanistik	Studim urbanistik për gjithë komunën	Komunë urbanizuar	2 vite	100000	Komuna Ekspertë	Plani urbanistik
	Evidentim dhe vlerësim pasurish natyrore dhe kulturoro-historike	1-Regjistrimi i pyjeve dhe kullotave 2-evidentim dhe vlerësim i historikut dhe Kulturës së Komunës Golaj	Pasuri natyrore të inventarizuara, të studiuara Pasuri kulturoro-historike të promovuara	2 vite	100000	Komuna ZRPP Ekspertë	Siperfaqe e pyjeve dhe kullotave të evidentuara dhe vlerësuara Pasuri kulturoro-historike të evidentuara dhe të promovuara

MATRICA E PROJEKTEVE VITI 2013

Nr	Emertimi aktivitetit Veprimi	Veprimi	Pritshmeria	Afati viti	Fondi nevojshem	Kush mund ta financoje	Indikatorët Treguesit e matshem
1	Përmirësim infrastrukturës rrugore	1-Asfaltimi i rrugës prej Krumës-Vlahen qëndër 2-Asfaltimi i rrugës Vlahen – Nikoliq qëndër dhe Unaza ne Golaj	Rritje mundësish për zhvillim socio-ekonomik	1 vit	a.820 000 \$ b.960 000 \$	1-Fondi Shqiptar i Zhvillimit 2- Fondi Shqiptar i Zhvillimit	Metër lineare asfaltim
	Përmirësim sistemit vaditës	1-Ndërtimi i kanalit vaditës në fshatin Helshan 2-Rehabilitimi i digës së rezervuarit Letaj 3- Ndërtimi i kanalit vaditës Peraj – Zgjec	Përmirësimi i nivelit të jetës së banorëve nëpërmjet mundësive për zhvillim të bujqësisë.		a.350 000 \$ b.150000\$ c.330000\$	1-Buxheti i shtetit	Meter linera kanale të ndërtuara dhe të rehabilituara, sipërfaqe toke e ujitur, sasi prodhimi e përfituar.
	Përmirësim infrastrukturës arsimore	1-Rehabilitimi i shkollës Kosturr 2-Rehabilitimi i shkollës Vlahen	Rritje mundësish për arsimin bashkëkohor		1-10 000 \$ 2-15 000 \$	1-Buxheti i shtetit	Numri i shkollave të rehabilituara, numri i klasave për nxënës, metër katrore oborre shkollore etj.

MATRICA E PROJEKTEVE VITI 2014

Nr	Emërtimi i aktivitetit Veprimi	Veprimi	Pritshmëria	Afati - viti	Fondi nevojshëm 000/leke	Kush mund ta financojë	Indikatorët Treguesit matshëm
1	Përmirësim i infrastrukturës rrugore	Trotuare dhe ndriçim në qendër të Komunës Golaj	Rritje mundësish për zhvillim socio-ekonomik	1 vit	500 000 €	Qeveria shqiptare	Metra katrore trotuare, numër neonesh për trotuare etj.
	Përmirësim i infrastrukturës shkollore	1-Ndërtimi i shkollës 9-vjeçare në Helshan 2-Rehabilitimi i shkollës 9-vjeçare Letaj 3-Ndërtimi i një kalçeto (fushe sporti) në qendër të Komunës Golaj	Rritje mundësish për arsimin bashkëkohor	1 vit	a.400 000 \$ b.630 000 \$ c.60 000 \$	1-Buxheti i shtetit 2-Buxheti i shtetit 3-50% komuna, 50% buxheti i shtetit	Numri i shkollave të ndërtuara dhe të rehabilituara, numri i klasave për nxënës etj

MATRICA E PROJEKTEVE VITI 2015

Nr	Emërtimi i aktivitetit Veprimi	Veprimi	Pritshmëria	Afati viti	Fondi nevojshëm 000/leke	Kush mund ta financojë	Indikatorët Treguesit matshëm
	Përmirësim i ujë -kanalizimeve	1-Ujësjetlesi I fshatit Golaj 2-Ujësjetlesi në fshatin Zgjec 3-Ndërtimi i kanalit të ujrave të zeza në fshatin Letaj, lagjia Çunaj	Rritje mundësish për përmirësim të shërbimeve ndaj qytetarëve, përmirësim të kushteve higjieno-sanitare, shëndet më i garantuar.	2 vite	a. 500 000 \$ b.150 000 € c. 250 000 \$	UNDP FSHZH 3- Buxheti i shtetit	Numri i ujësjetlesve të ndërtuar, numri i çezmave në shtëpi etj.
	Përmirësim shërbimesh socio-kulturore	Ndërtimi i një Xhamie në fshatin Golaj,	Rritje mundësish për zhvillim socio-kulturor	1 vit	50 000 \$,	Donatorë	Xhamia e ndërtuar, numri i besimtarëve që e frekuentojnë etj.

ANEX 1 GRUPI KONSULTATIV GOLAJ

Nr	Emri	Mbiemri	Vendbanimi	Telefon
1	Abdullah	Neza	Helshan	-
2	Syl	Gaxha	Helshan	-
3	Binak	Nezaj	Perollaj	-
4	Din	Maci	Bardhaj	-
5	Avni	Dauti	Golaj	-
6	Fadil	Brati	Golaj	0692702757
7	Ajshe	Gaxha	Golaj	-
8	Nadire	Brati	Golaj	-
9	Sadik	Xhafa	Nikoliq	0682402855
10	Astrit	Ngjeci	Nikoliq	-
11	Gani	Hoti	Qarr	0693849275
12	Ganimete	Dauti	Golaj	-
13	Rezarta	Cufaj	Golaj	-
14	Man	Rexha	Golaj	0692433613
15	Jah	Dauti	Golaj	0692502812

VENDIMI I KESHILLIT TE KOMUNES GOLAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË KËSHILLI I KOMUNES GOLAJ

V E N D I M

Nr.36, datë 28. 10. 2012

“PËR MIRATIMIN E PLANIT TE VEPRIMIT TE KOMUNES GOLAJ 2012-2016”

Këshilli I Komunes Golaj, pasi mori në shqyrtim relacionin për “Planin e Veprimit te Komunes Golaj per vitet 2012-2016” si dhe në mbështetje te nenit 7 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 për “Organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (i ndryshuar), me propozim të Kryetarit të Komunes;

V E N D O S I:

1. Të miratojë Planin e Veprimit te Komunes Golaj per vitet 2012-2016.
2. Ngarkohet administrata e komunes per zbatimin e ketij vendimi..
3. Ky vendim hyn në fuqi 5 (pese) ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

Miftar Dauti



KRYETARI

Shefqet Dauti